

# SiCRED fitues i Çmimit

## "Shërbimi më i mirë ndaj Publikut"

### E para në tregun e sigurimit të jetës në Janar 2016

Më 13 Dhjetor 2015, në një mbrëmje gala, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë ndau çmimet e përvitshme të sipërmarrjeve më të suksesshme të vitit.

Shoqëria e Sigurimit të Jetës SiCRED është nderuar në këtë event, me çmimin "Shërbimi më i Mirë ndaj Publikut", me motivacionin për shërbim inovativ me paketa sigurimi të personalizuar për kërkesat e klientëve.



Produkte sigurimi me përfitime reale, zbatimi rigoroz i kushteve kontraktuale, transparenca dhe sjellja etike ndaj çdo të siguruari, profesionalizmi i stafit, si dhe edukimi i vazhdueshëm i publikut, janë vlera të shtuara që shoqëria SiCRED i ofron tregut shqiptar.

#### E para shoqëri private e sigurimit të Jetës me kapital 100% shqiptar

SiCRED është shoqëria e parë private e sigurimit të jetës me kapital 100% shqiptar. Me një rritje të qëndrueshme dhe të vazhdueshme në mbi 12 vitet e aktivitetit të saj, me një larmi produktesh sigurimi, SiCRED u ofron shërbim tepër të personalizuar mbi 60.000 klientëve të saj në Shqipëri. Gjatë vitit 2015 jemi fokusuar në përmirësimin e produkteve të shëndetit dhe tashmë ofrojmë përfitimet dhe shërbimet më të mira mjekësore nëpërmjet rrjetit mjekësor prej mbi 60 spitale dhe klinika cilësore private në Shqipëri, rajon dhe vendet e Bashkimit Evropian. Produktet e Sigurimit nga SiCRED ofrojnë asistencë mjekësore në të gjithë botën nëpërmjet shërbimit të ofruar nëpërmjet një kompanie asistencë ndërkombëtare.

#### Pozicioni i SiCRED në tregun e sigurimeve në Shqipëri

Prej disa vitesh, SiCRED është konsoliduar në Sigurimin e Jetës duke rritur pjesën e vet të tregut vit pas viti, duke u pozicionuar në vendin e dytë. Gjatë vitit 2015, primet e shkruara nga SiCRED, u rritën me 8.84% krahasuar me vitin 2014, duke përfaqësuar rritjen më të lartë të primeve në tregun e sigurimit të jetës. Ndërsa në muajin Janar 2016, SiCRED kryeson tregun e sigurimit të jetës me 54% të primeve të shkruara në këtë treg.



#### SiCRED, aty ku klienti zgjedh!

Me sloganin "Në Duar të Sigurta" SiCRED ka mundur t'i ofrojë shërbim e produkte cilësore individëve të çdo grupmoshe, familjeve, sipërmarrjeve e shoqërive private dhe institucioneve shtetërore apo grupeve të ndryshme të interesit.

Gjithashtu, SiCRED me dy kompanitë e tjera të grupit, ku SiCRED ka një prezencë të qenësishme deri në 100% të kapitalit, konkretisht SiCRED Pensions dhe SiCRED ASSISTANCE, i ofron klientëve një gamë të gjerë dhe të plotë produktesh financiare, nëpërmjet të cilave arrihet të maksimizohen përfitimet edhe nëpërmjet benefiteve dhe lehtësirave fiskale. SiCRED ASSISTANCE ofron shërbime konsulence dhe asistencë shoqërive të vogla, të mesme dhe të



mëdha për të arritur nivele të kërkuara nga ligji, në lidhje me sigurinë e jetës dhe shëndetit në punë. Vit pas viti vërehet një rritje e numrit të kompanive që ofrojnë pensione private për stafet e tyre. Një interesim i lartë regjistrohet nga bizneset familjarë, që duan të maksimizojnë përfitimet e tyre, duke investuar në pensione private me qëllim që të kenë një pension të sigurt. Një numër jo i vogël kompanish private kanë kërkuar shërbimin e SiCRED ASSISTANCE për të plotësuar kërkesat e ligjit për kriteret e sigurisë së jetës dhe shëndetit në punë.

Me stafin e saj cilësor e të mirëtrajnuar, SiCRED jo vetëm ka individualizuar së tepërmi shërbimin për klientët, por ka qenë në çdo moment në favor të klientit pa bërë asnjë lloj dallimi, duke qenë sa më i ndershëm e duke e vënë klientin në çdo moment në qendër të vëmendjes, për t'i dhënë një shërbim sa më cilësor e me kushte dhe termat financiare më të mira të mundshme.

#### E para shoqëri sigurimesh me produkte bankë-sigurime

Në një treg ku mbetet ende shumë për të bërë, e të vështirë dhe duke marrë parasysh situatën ekonomike e gjeopolitike mbarë botërore, SiCRED ka qenë e para shoqëri sigurimesh që ka arritur të krijojë e zbatojë produktet e kombinuara të bankë-sigurimeve të aplikuara gjerësisht, një risi tepër e veçantë për tregjet financiare, si dhe për tregun e sigurimit të jetës në Shqipëri. Vetëm gjatë vitit të fundit, mbi 5.000 klientë falë kësaj risie kanë përfituar për herë të parë ofertat dhe shërbimet më cilësore, ndërkohë që numri i klientëve që kanë përfituar nga këto produkte është rreth 15.000.

#### Krijimi i Shoqatës së Siguruesve të Jetës, Pensioneve Private dhe Fondeve të Investimit

Viti 2015 ka qenë një vit tepër i rëndësishëm për tregun e sigurimeve të jetës. Pas disa vitesh kërkesë veçanërisht nga kompanitë e sigurimit të jetës, por edhe nga shoqëritë private të fondeve vullnetare të pensionit, të cilat natyrshëm kanë lidhje me kompanitë e sigurimit të jetës është bërë i mundur finalizimi i një shoqate për mbrojtjen e interesave të kompanive të sigurimit të jetës, pensione private dhe fondeve të investimit, duke qenë një nismë pozitive për tregun e sigurimeve, e veçanërisht për sigurimin e jetës. Krijimi i Shoqatës së Siguruesve të Jetës, Pensioneve Private dhe Fondeve të Investimit, pritet të japë një impakt të ri në treg dhe përfaqësim më dinjitoz të këtyre grupeve të interesit në tregun Shqiptar.



#### Sponsorizime

Duke pranuar përgjegjësinë që ka ndaj komunitetit që e rrethon, SiCRED ka qenë një kontribuues i vazhdueshëm i artit, sportit dhe aktiviteteve të tjera.

Gjatë vitit 2015 SiCRED ka mbështetur:

- Organizimin e Konferencës së Parë Ndërkombëtare të Traumës e organizuar nga Shoqata Shqiptare e Traumatologjisë.
- Qendrën TISS duke lancuar fushatën "Prano Autizmin" në mbështetje të fëmijëve autik.
- Festivalin VOX Baroque II, festivali i muzikës së vjetër europiane me pjesëmarrjen e artistëve të njohur shqiptarë dhe evropianë.
- Pjesëmarrjen e Ekipit të Minifutbollit të Universitetit të Tiranës, në aktivitetin sportiv "Euro Roma 2015".

#### E ardhmja e SiCRED

Duke qenë të angazhuar në krijimin dhe zbatimin e produkteve të avancuara të sigurimeve të jetës të aplikuara gjerësisht në sektorin financiar dhe atë bankar, SiCRED do të jetë vazhdimisht në kërkim të mundësive të edukimit të gjerë të shqiptarëve në zgjedhjen e produkteve të sigurimit të Jetës.

SiCRED do të vazhdojë natyrshëm rritjen e tij të sigurt për t'u bërë shoqëria LIDER në të gjitha produktet që ofron.

# 12 vite tashmë, jeni në duar të sigurta!



**Punët bëhen gjithmonë më të mira, kur i beson në duar të sigurta.** Kështu ne të SiCRED mendojmë për **12 vite tashmë**, për secilin prej **60,000 klientëve tanë**. Ndaj, ne ofrojmë gjithmonë shërbimet e cilësisë së lartë në produkte të sigurimit të jetës dhe shëndetit për individë, familje e biznese dhe investojmë në staf të kualifikuar duke ofruar të parët produkte të avancuara bankë – sigurime. Dhe kjo është arsyeja që jemi **shpërblyer me çmimin e kompanisë së sigurimit me shërbimin më të mirë ndaj publikut.**

Ne jemi SiCRED. Dhe ju jeni në duar të sigurta!

 **SiCRED**  
Shoqëri Sigurimi Jete